



Albania
Investment
Council

Improving Transparency and Investment Climate

MBI DISA ASPEKTE TË KLIMËS SË INVESTIMEVE PERCEPTIME TË BIZNESIT

Sekretariati i Këshillit të Investimeve

Dhjetor 2025

I. OBJEKTI DHE METODOLOGJIA

II. NDËRVEPRIMI ME ADMINISTRATËN QENDRORE TATIMORE

III. RIMBURSIMI I TVSH-së

IV. INFORMALITETI

V. INTEGRIMI NË BASHKIMIN EVROPIAN

OBJEKTI I VROJTIMIT

- ✓ Evidentimi i dinamikave në:
 - fushën e mirëadministrimit tatimor dhe
 - sfidave të SMEve në kuadrin e integritimit në tregun e përbashkët evropian

METODOLOGJIA

- ✓ Pyetësor i strukturuar dërguar online bizneseve sipas databzës së Sekretariatit
- ✓ Në bashkëpunim me AIDA, WECA, CCI Tirana, Confindustria Albania
- ✓ Pyetsorë të plotësuar online në mënyrë anonime nga 188 biznese
- ✓ Anketa përfshin të dhëna të raportuara gjatë periudhës Shtator – Nëntor 2025
- ✓ Analiza e të dhënave përmban edhe krahasime të dhënash me rezultate të anketave në vitet e mëparshme (aty ku është e mundur)


II. Kontrolli Tatimor, Informimi dhe Komunikimi me Administratën Tatimore Qendrore

BIZNESI MBI MARRËDHËNIET ME ADMINISTRATËN QENDRORE TATIMORE

- *Bizneset raportojnë një përmirësim të përgjithshëm në marrëdhëniet e tyre me Administratën Tatimore Qendrore:*
 - *Llojet e kontrolleve tatimore paraqesin një trend të qëndrueshëm, duke kontribuar në një ndjesi parashikueshmërie për bizneset.*
 - *Rritje e profesionalizmit të grupeve të kontrollit krahasuar me vitet e fundit, megjithëse niveli i sotëm mbetet më i ulët se periudha më pozitive 2017–2018. Kjo tregon për përmirësim progresiv, por edhe për potencial të pashfrytëzuar për rikthimin në standardet më të larta të viteve të mëparshme.*
 - *Raportet tatimore janë perceptuar si më të qarta në përmbajtje, format, referenca dhe gjetje – një rritje krahasuar me periudhën 2019–2022. Megjithatë, ashtu si me profesionalizmin, edhe këtu standardet e 2017–2018 mbeten ende pikë referimi që nuk është arritur plotësisht.*
 - *Është rritur pjesëmarrja e bizneseve në trajnime mbi legjislacionin fiskal.*
- *Digjitalizimi shihet me trend pozitiv, veçanërisht në: besueshmërinë e të dhënave, aksesin, cilësinë e të dhënave. Kjo rrit efikasitetin e bashkëveprimit të bizneseve me administratën dhe është faktor kyç në rritjen e transparencës, qartësisë dhe profesionalizmit.*
- *Apelimet tregojnë trend të qëndrueshëm, por ka rritje të vendimeve në favor të bizneseve. Kjo mund të interpretohet si rritje e profesionalizmit të strukturave të apelimit, ndoshta korrigjim i vendimeve të padrejta, ose rritje e kapacitetit të bizneseve për të argumentuar rastet e tyre (falë trajnimeve dhe rritjes së qartësisë).*
- *Megjithë përmirësimet në administratë, gjyqësori mbetet pika më problematike: pasiguri juridike, procedura të gjata, kompleksitet i legjislacionit.*

KONTROLLET TATIMORE (2015-2024)

Për periudhën 2015-2024 - struktura e llojeve të kontrolleve mbetet e qëndrueshme por kemi rritje të kontrolleve të plota kundrejt vizitave fiskale.




KONTROLLET TATIMORE (2015-2024)

PROFESIONALIZMI I INSPEKTORËVE (2017 – 2025)

Lutemi jepni vlerësimin tuaj për profesionalizmin e grupit të inspektorëve tatimorë që kanë inspektuar kompaninë tuaj

Rritje e profesionalizmit të grupeve të kontrollit krahasuar me vitet e fundit, megjithëse niveli i sotëm mbetet më i ulët se periudha më pozitive 2017–2018. Kjo tregon për përmirësim progresiv, por edhe për potencial të pashfrytëzuar për rikthimin në standardet më të larta të viteve të mëparshme.

Profesionalizmi i Grupit të Kontrollit Tatimor




KONTROLLET TATIMORE (2015-2024)

QARTËSIA E RAPORTIT TATIMOR
2017 – 2025 Lutemi vlerësoni
qartësinë e Raportit të Kontrollit
Tatimor të lëshuar pas një
Kontrolli Tatimor

*Raportet tatimore janë perceptuar si më të qarta në
përmbajtje, format, referenca dhe gjetje – një rritje
krahasuar me periudhën 2019–2022. Megjithatë, ashtu si
me profesionalizmin, edhe këtu standardet e 2017–2018
mbeten ende pikë referimi që nuk është arritur plotësisht.*


Raporti i Kontrollit Tatimor



APELIMET TATIMORE 2018 – 2025


A keni apeluar ndonjë nga vendimet e kontrollit tatimor? Nëse po, vendimi i apelimet tatimor ka qenë në favor të administratës tatimore apo biznesit tuaj?

Apelimet ndaj vendimeve të kontrollit tatimor



Me përjashtim të vitit 2019, apelimet kanë shfaqur një trend të qëndrueshëm gjatë viteve.


Vendimi i apelimet




Ndërkohë, vërehet një trend rritës i vendimeve të apelimet në favor të bizneseve.

ANKIMIMET NË GJYKATË

A e keni ankimuar vendimin e organit të
apelimit tatimor në gjykatën
administrative?




Problematikat më të shpeshta që një biznes has gjatë
trajtimit të çështjeve të tij me institucionet fiskale në
gjykatë




Vërehet trend në rënie përsa i përket ankimimit në gjykatën administrative krahasuar me vitin 2022. Pasiguria juridike, procedura të gjata të gjyqësorit dhe kompleksiteti i legjislacionit fiskal konsiderohen problematikat më të hasura në gjyqësor.

TRAJNIMET NGA DPT


Pjesëmarrja në sesione trajnimi të ofruara nga DPT mbi zbatimin e legjislacionit tatimor mbi procesin e fiskalizimit?



Pjesëmarrja në sesione trajnimi të ofruara gjatë viteve të fundit nga DPT mbi zbatimin e legjislacionit tatimor?




A keni marrë pjesë në sesione trajnimi nga Administrata Tatimore mbi zbatimin e ligjit të ri mbi të ardhurat?



Vërehet një trend rritës në pjesëmarrjen në trajnime, sidomos lidhur me zbatimin e legjislacionit tatimor në përgjithësi dhe të fiskalizimit dhe ligjit mbi të ardhurat në veçanti.

KOMUNIKIMI ME ADMINISTRATËN TATIMORE

Si do ta vlerësonit ju ndryshimin e komunikimit të administratës tatimore
në dy vitet e fundit:




*59% e bizneseve në 2025 mendojnë se **komunikimi me administratën tatimore është përmirësuar**, tregues ky në rritje krahasuar me periudhat 2019/2024; edhe pse më i ulët se perceptimi i bizneseve në vitin 2018.*

SHËRBIMET ELEKTRONIKE TATIMORE

2017 - 2025


Ka një reagim me trend më pozitiv ndaj besueshmërisë së të dhënave, aksesit dhe cilësisë së të dhënave duke filluar nga viti 2022, megjithatë në nivele më të ulëta krahasuar me periudhën 2017–2019.

Vlerësimi mbi kënaqësinë ndaj shërbimeve elektronike të
DPT - i kënaqur/Shumë i kënaqur




SISTEMI I FISKALIZIMIT 2022 – 2025

Vlerësimi mbi kënaqësinë me shërbimin e klientit të ofruar në lidhje me procesin e fiskalizimit



Në vitin 2025 vërehet një rritje e perceptimit të bizneseve lidhur me kënaqësinë nga shërbimi ndaj klientit në procesin e fiskalizimit, megjithatë ende 7 nga 10 kompani mendojnë se është e nevojshme krijimi i një shërbimi elektronik me telefon.

A mendoni se procesi i fiskalizimit ka nevojë për ngritjen e një shërbimi elektronik me telefon (call centre)?



III. RIMBURSIMI I TVSH-SË

BIZNESI MBI RIMBURSIMIN E TVSH-së


- *Rreth 1 në 2 kompani që kanë të drejtë për rimbursim zgjedhin të aplikojnë për përfitimin e TVSH-së së rimbursueshme. Kjo tregon një **nivel të moderuar besimi** dhe sugjeron se një pjesë e bizneseve hezitojnë ende të përfshihen në proces kushtëzuar nga: mungesa e besimit, kompleksiteti i procedurës në sistemin elektronik.*
- *Për kompanitë që aplikojnë, **procesi rezulton shumë efektiv**: 9 nga 10 kompani e përfitojnë rimbursimin. Kjo normë e lartë suksesi bie ndesh me mungesën e besimit që përmendet si arsye kryesore për mos-aplikim – duke sugjeruar se perceptimi nuk përputhet me realitetin e efektivitetit të procesit.*
- *Rimbursimi merret kryesisht pas ushtrimit të kontrollit tatimor, por që nga viti 2022 ka një rritje të ndjeshme të rasteve të rimbursimit automatik nga sistemi. Kjo tregon se administrata po ecën drejt automatizimit dhe besimit, çka lidhet drejtpërdrejt me rritjen e besimit tek procesi.*
- *Krahasuar me vitin 2022, është rritur ndjeshëm besimi tek **platforma digjitale e rimbursimit**: 7 në 10 kompani deklarojnë se platforma ka lehtësuar procesin. Kjo tregon se digjitalizimi është një faktor kyç që po redukton barrierat administrative dhe po përmirëson përvojën e biznesit.*

RIMBURSIMI I TVSH-së


Konsiderohet trend që përgjithësisht 1 në 2 kompani subjekt rimbursimi i TVSH-së (duke përfshirë vitin 2022) aplikojnë për të përfituar rimbursim të TVSH-së.

Mungesa e besimit për përfitimin e rimbursimit, procedura e komplikuar në sistem janë dy arsye kryesore të mos-aplikimit për rimbursim.

Aplikimet për rimbursim të TVSH-së gjatë periudhës 2022 - 2024?



Nëse nuk keni aplikuar për rimbursimin e TVSH-së, lutemi identifikoni arsyet




RIMBURSIMI I TVSH-SË


Përgjatë 2025, rimbursimi TVSH-së konsiderohet problematik, vetëm nga 3 në 10 kompani.

Krahasuar me perceptimet e vitit 2022, është rritur besimi tek platforma dixhitale e rimbursimit për të cilin 7/10 kompani deklarojnë se ka lehtësuar procesin, në masë më të madhe për eksportuesit.


Përgjithësisht, a e konsideroni rimbursimin e TVSH-së sot ende një problematikë për biznesin tuaj?



Platforma digjitale e rimbursimit të TVSH-së:



Platforma digjitale e rimbursimit të TVSH-së:




IV. INFORMALITETI

- *Që nga viti 2017 e deri më sot, perceptimi i informalitetit në vend mbetet i qëndrueshëm dhe i lartë: 7 nga 10 kompani deklarojnë se informaliteti është i pranishëm në treg. Kjo stabilitet tregon se, pavarësisht ndërhyrjeve të viteve të fundit, informaliteti perceptohet ende si një fenomen i rrënjosur dhe i vazhdueshëm.*
- **Faktoret nxitës** - *Edhe në vitin 2025, bizneset identifikojnë të njëjtët faktorë kryesorë të nxitjes së Informalitetit: Korrupsioni dhe Konkurrenca e pandershme.*
- **Natyra e Informalitetit**, sipas renditjes nga më i rëndësishmi te më pak i rëndësishmi, është *Shmangia e taksave, Puna në të zezë, Korrupsioni, Mosregjistrimi i aktiviteteve apo subjekteve.*
- **Sektorët - Diferenca sektoriale në perceptimin e informalitetit:**
 - *Tek Industria informaliteti perceptohet kryesisht si: Shmangie taksash, Punë në të zezë.*
 - *Ndërtimi percepton informalitet të përzier ndërmjet: Shmangies së taksave, Punës në të zezë, Korrupsionit.*
 - *Shërbimet vërejnë informalitet të shfaqur si: Shmangie taksash e alternuar me mosregjistrim dhe punë në të zezë.*

INFORMALITETI DHE KONKURRENCA INFORMALE

Në vitin 2025, afërsisht 8 nga 10 kompani perceptojnë konkurrencë nga aktivitetet informale në vend. Ky trend ka qenë i qëndrueshëm gjatë viteve – mesatarisht që nga viti 2018, gati 7 nga 10 kompani raportojnë pranimë të informalitetit në vend.


Vlerësimi mbi konkurrencën nga aktivitete informale në sektorin ku operoni



INFORMALITETI DHE KONKURRENCA INFORMALE 2018-2025

*Konfirmohet se **Shmangia e taksave dhe Puna në të zezë** janë dy format më të përhapura të informalitetit edhe për vitin 2025, edhe pse me tendenca rënie vit pas viti.*


Vlerësimi mbi natyrën e aktiviteve informale në sektorin ku operoni



FAKTORI MË I RËNDËSISHËM QË NXIT INFORMALITETIN

Konkurrenca e pandershme dhe Korrupsioni janë dy faktorët kryesorë që nxisin informalitetin sipas perceptimit të biznesit edhe gjatë vitit 2025.

Shkalla e influencës në vendimin e një biznesi për të ndërmarrë riskun e një aktiviteti informal




- *Bizneset perceptojnë klimën e biznesit në Shqipëri si të ndikuar kryesisht nga tre elementë kritikë:*
 - *Efikasiteti i sistemit gjyqësor dhe mbrojtja e të drejtave*
 - *Niveli i korrupsionit dhe transparencë institucionale*
 - *Cilësia dhe kostot e fuqisë punëtore*
- *Të tre këta faktorë lidhen ngushtë: një sistem gjyqësor i dobët dhe korrupsioni ulin besimin dhe sigurinë për biznesin, ndërsa sfidat me fuqinë punëtore dhe kostot e saj ndikojnë në produktivitet dhe konkurrueshmëri.*
- *Përmirësimi i këtyre elementëve është kritik për të përmirësuar klimën e biznesit dhe për të tërhequr investime të qëndrueshme.*

1. *Efikasiteti i sistemit gjyqësor dhe mbrojtja e të drejtave të biznesit*
2. *Niveli i korrupsionit dhe transparenca institucionale*
3. *Cilësia e fuqisë punëtore dhe kostot e saj*

*Vlerësohen nga biznesi si **elementët më kritikë** dhe që kërkojnë vëmendje në lidhje me klimën e të bërit biznes në Shqipëri.*

Klima e të bërit biznes - Elementët më kritikë:





Albania
Investment
Council

Improving Transparency and Investment Climate

V. INTEGRIMI NË TREGUN E PËRBASHKËT EVROPIAN


BIZNESI MBI INTEGRIMIN NË BE

- **Mbi Informimin** - mungesë të dukshme informacioni mbi: Agjendën Kombëtare të Reformave, Procesin e integrimit në BE. Informacionin e marrin kryesisht nga interneti dhe mediat tradicionale, ndërsa presin më shumë transparencë dhe udhëzime nga institucionet shtetërore dhe institucionet/projektet e BE-së. Kjo mungesë informacioni ka implikime direkte mbi kapacitetin e bizneseve për të planifikuar zhvillimin dhe përfitimet nga reformat.
- **Pritshmëritë** - përfitime potenciale nga një proces i konsoliduar i reformave: Konsultim më gjithëpërfshirës i bizneseve në hartimin e reformave, Përfitime direkte për bizneset, Përsheptimi i zbatimit të reformave, duke krijuar efikasitet dhe siguri ligjore.
 - **Sektorët më optimistë:** Industria, Tregtia, Bujqësia, Transporti.
 - **Nivel kompanie:** Përmirësim i standardeve dhe cilësisë, Rritje e konkurrencës së ndershme, Qasje më e lehtë në tregjet e BE-së. Por vetëm 3 nga 10 kompani presin rritje të mundësive të eksportit.
 - Rreth 1 në 2 kompani parashikojnë zgjerim të aktivitetit pas integrimit. Kjo tregon një lidhje të fortë mes perceptimit pozitiv të integrimit dhe potencialit për zhvillim të biznesit.
- **Sfidat** - Adoptimi i ligjeve pa konsultim, duke reduktuar transparencën dhe besueshmërinë, burokracia dhe procedurat administrative, Taksa dhe legjislacioni fiskal, Standardet e prodhimit që kërkojnë përshtatje për tregjet evropiane. Këto sfida lidhen ngushtë me mungesën e informacionit dhe me perceptimin e barrierave ndaj reformave.

BIZNESI MBI AGJENDËN KOMBËTARE TË REFORMAVE

MBI INFORMIMIN - Vetëm 33% e kompanive të intervistuar deklarojnë të kenë informacion (shumë/disi) mbi Agjendën Kombëtare të Reformave.


Sa informacion keni mbi Agjendën Kombëtare të Reformave?




BIZNESI MBI AGJENDEN KOMBËTARE TË REFORMAVE

PRITSHMËRITË - Kompanitë që kanë informacion mbi AKR, perceptojnë se zbatimi i saj në 3 vitet e ardhshme do të sjellë kryesisht konsultim gjithëpërfshirës, përfitime direkte për bizneset; ndërkohë adoptimi i pakonsultuar i ligjeve shihet si sfida më e madhe në zbatimin e AKR.

Cilat janë pritshmëritë tuaja nga zbatimi i
Agjendës së Reformës gjatë 3 viteve të
ardhshme?




Çfarë rreziqesh ose sfidash shihni në zbatimin e
Axhendës së Reformës?



BIZNESI MBI ANTARËSIMI NË BE

PRITSHMËRITË NË NIVEL FIRME - Afërsisht 7 në 10 kompani vlerësojnë pozitiv/shumë pozitiv antarësimin e Shqipërisë në BE; më pozitivë shprehen eksportuesit, bizneset me xhiro mbi 10 mln dhe Ndërtimi, Bujqësia dhe Industria (Industria përpunuese)

Si e vlerësoni anëtarësimin e Shqipërisë në BE për biznesin tuaj?




BIZNESI MBI ANTARËSIMIN NË BE


PËRFITIME - përmirësim i standardeve dhe cilësisë, rritje e konkurrencës së ndershme dhe qasje më e lehtë në tregjet e BE-së janë përfitimet kryesore që bizneset presin nga anëtarësimi.

SFIDA - burokracia dhe procedurat administrative, taksa dhe legjislacioni fiskal si edhe Cilësia e produkteve/Standardet e prodhimit perceptohen si fushat ku do të jetë më e vështirë përshtatja

Cilat përfitime prisni më shumë nga anëtarësimi në BE?




Në cilat fusha mendoni se do të jetë më e vështirë përshtatja?



EKSPORTET - Vetëm 3 në 10 biznese presin më shumë mundësi eksportimi nga antarësimi: Industria, Tregtia dhe Bujqësia janë më optimistët.

A prisni që biznesi juaj të ketë më shumë mundësi eksporti pas anëtarësimit (zgjerim tregu për produktin tuaj)?




BIZNESI MBI ANTARËSIMI NË BE

MBI INFOMIMIN - afro 50% deklarojnë se janë të interesuar e u nevojitet më shumë informacin në lidhje me integrimin dhe ndikimin në biznes.

Më të informuar shfaqen eksportuesit, kompanitë e mëdha (mbi 8 mln xhiro) dhe sektorët TIK, Industria përpunuese dhe shërbimet.


BURIMET E INFORMIMIT - Interneti dhe Mediat tradicionale; ndërkohë bizneset presim më shumë nga institucionet shtetërore dhe institucione/projekte të BE.




PRITSHMËRITË NË NIVEL FIRME - 1 në 2 biznese e sheh veten me rritje e zgjerim pas antarësimit në BE.

Kryesisht, Industria përpunuese, Bujqësia, pyjet dhe peshkimi dhe Transporti dhe magazinimi.

Si e shihni biznesin tuaj pas 5–10 vitesh antarësim të vendit në BE?



FALEMINDERIT!



Këshilli i Investimeve mbështetet nga Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, BERZH dhe Sekretariati Shtetëror Zvicerian për Çështje Ekonomike (SECO).